



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.388/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Basri Menxhiqi, kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Vushtrisë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Vushtri, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave me postë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 05.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.388/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Basri Menxhiqi, kandidatë për Kuvendin Komunal në Komunën e Vushtrisë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Vushtri, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave me postë, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.388/2025, e parashtruar nga Basri Menxhiqi, kandidatë për Kuvendin Komunal në Komunën e Vushtrisë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, PDK dega në Vushtri, në të cilën thekson se në zgjedhje kam garuar me numrin 7, në disa vendvotime ka probleme të mëdha e të cilat natyrisht kanë edhe ndikimin e tyre në rezultatet e secilit kandidatë për Kuvendin Komunal, andaj duhet theksuar faktin se këto probleme janë mjaft serioze dhe si të tilla ndikojnë në renditjen e kandidatëve. Tutje në ankesë theksohet se në raport me mua si kandidatë, konsideroj se më së shumti jam dëmtuar nga mos evidentimi i votës sime, të ardhura nga diaspora, si dhe në vendvotimin e caktuar, ku kane votuar familjaret e mi.

Po ashtu ankuesi konsideron se ka pasur parregullësi të medha në Qendren e Numërimit të votave, sa i përket votave të derguara me post nga diaspora, sepse këtu nuk figurohen të gjitha votat e mija e në fakt familjart e ngusht, duke i perfillur të gjitha procedurat, kane votuar votues familjar, dhe kane derguar plikon zarfin me kohe në adresë të KQZ-së.

Këta votues kanë bindjen dhe siguri të plotë se me kane votuar mua si kandidatë, pasi që edhe jane familjar të mi, madje të njejtit kane shprehur edhe dëshire që të deklarojne me shkrim se me kane votuar mua.

Po ashtu parashtuesi thekson se aktualisht, sipas rezultateve zyrtare, unë kam gjithsej 211 vota, por jam i bindur se 6 vota nga diaspora nuk janë përfshirë në këtë numërim, si dhe këto vota janë vendimtare për rezultatin tim si kandidat për Asamblenë Komunale dhe përfshirja e tyre në numërim mund të ndikojë drejtpërdrejt në ndryshimin e renditjes sime dhe në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, si dhe kërkon nga PZAP që të urdhërohet Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) për rinumerimin e votave nga diaspora për Komunën e Vushtrisë. Në ankesë ka bashkangjitur si prove, deklaratat si deshmi të votuesve.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, gjithashtu ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 Për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 17. Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.

Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre, Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shqyrtimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesit Basri Menxhiqi kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Vushtrrisë nga subjekti politik PDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet fakti me prova konkrete se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave sa i përket votave të derguara me postë nga diaspora. Sipas vlerësimit të panelit vetëm pretendimi nga ankesa se “unë kam gjithsej 211 vota, por jam i bindur se 6 vota nga diaspora nuk janë përfshirë në këtë numërim. Këto vota janë dërguara nga familjarë të ngushtë, duke i përfillur të gjitha procedurat, kane votuar votues familjar, dhe kane dërguar plikon zarfin me kohe në adresë të KQZ-së, këta votues kanë bindjen dhe siguri të plotë se me kane votuar mua si kandidatë, pasi që edhe janë familjar të mi”, sipas vlerësimit të panelit këto pretendime janë të pabazuar për faktin se parashtruesi i ankesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij me prova konkrete, edhe vet ankuesi nuk është i sigurtë në pretendimet e tij të cilat paraqiten me shume si hamendsime të tij se sa pretendime reale, andaj rrjedhimisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse me kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin dhe në kuptim, paneli, në mungesë të dëshmive nuk mund të vërtetoj se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarin e të familjarëve të ngushtë, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, është përcaktuar se “1.3. liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjëse për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim.” Prandaj për këtë arsye nuk i mori si të bazuara, përkatësisht, nuk ia fali besimin deklarin se familjarët e ngushtë kanë votuar për të njëjtin, për të aprovuar ankesën si të bazuar.

Duhet cekur se lidhur me deklarata e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: “deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kane votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit”.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Basri Menxhiqi kandidat për Kuvendin Komunal në Komunën e Vushtrrisë nga subjekti politik PDK, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindëse që dëshmojnë parregullsi gjatë numërimit të votave me postë dhe mungesës së votave tek kandidati. Andaj pretendimet e ankuesit mbetet vetëm në suaza të dyshimit të arsyeshëm se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetohen pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLAnr.388/2025 datë 05.11.2025

Kryesuese e panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.